



Kronikë

# Lëvizte me armë me vete në makinë, pranga 23-vjeçarit nga Shkodra! I sekuestrohet edhe kanabis (EMRI+VIDEO)

*Xhordan Cafi u arrestua në aksin rrugor "Lezhë–Shkodër", në fshatin Mabë teksa lëvizte me një makinë tip BMW.*

Redaksia
23 Nëntor, 12:29 | **Përditesimi: 23 Nëntor, 12:43**

Share



Një 23-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Lezhës për armëmbajtje pa leje.

Xhordan Cafi u arrestua në aksin rrugor "Lezhë–Shkodër", në fshatin Mabë teksa lëvizte me një makinë tip BMW.

Blutë sekuestruan pistoletën dhe një sasi kanabisi që gjetën në shtëpinë e të riut në banesën e tij në lagjen "Salo Halili".



LEXO EDHE:
**Meshë në vendlindje, kardinal Ernest Troshani nga Lezha: T'ju udhëheqë devotshmëria e dashuria**

**Njoftimi i policisë:**

*Në vijim të punës për sigurimin e informacioneve me qëllim kapjen dhe arrestimin e personave që qarkullojnë të armatosur apo mbajnë në banesë armë zjarri pa leje, shërbimet e Sektorit të Policisë Rrugore në DVP Lezhë, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja", bazuar në informacionet e siguruara për një të ri që qarkullonte i armatosur, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Aksi".*

*Si rezultat i operacionit, në aksin rrugor "Lezhë–Shkodër", në fshatin Mabë, shërbimet e Policisë konstatuan një automjet tip BMW që dyshohej se udhëtonte i riu i armatosur dhe e ndaluan për të ushtruar kontroll.*

*Gjatë kontrollit fizik të drejtuesit të automjetit dhe të çantës që mbante me vete, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri pistoletë, me krehër dhe municion luftarak.*

*Në vijim të veprimeve procedurale, në bashkëpunim me shërbimet e DVP Shkodër, u ushtrua kontroll edhe në banesën e tij në lagjen "Salo Halili", në Shkodër, ku gjatë kontrollit shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një sasi të vogël lënde narkotike, e dyshuar kanabis.*

*Në përfundim të veprimeve procedurale, u arrestua në flagrancë shtetasi Xh. C., 23 vjeç, banues në Shkodër, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe Shkoder Xhordan Cafi armembajtje pa leje kanabis

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 20 Nëntor, 13:08

Kë ka luftuar më shumë SPAK deri sot?

Korrupsionin | Krimin e organizuar | Asnjërën

## Lajme të tjera



Veri-Jug/ 'Mir se t'ka pru zoti n'Fisht', udhëtimi përgjatë 'Shtegut të Poezisë Fishtane' dhe bujtinat e Toskanës shqiptare

23 Nëntor, 14:04



Reshjet e dëborës në Qafë Thore-Theth, vijon puna për pastrimin e segmentit rrugor (VIDEO)

23 Nëntor, 12:24



Moti i keq/ Lëpusha dhe mali i Krrabit nën petkun e dëborës, pamjet mahnitëse (VIDEO)

23 Nëntor, 11:30



Problematike situata në fshatrat e Lezhës, sipërfaqe tokash bujqësore të përmbytura nga uji (VIDEO)

23 Nëntor, 10:27



Reshjet e dëborës në Bogë-Theth, trashësia arrin deri në 40 cm (VIDEO)

23 Nëntor, 09:48



Moti i keq/ Vihet në punë hidrovori i Tales në Lezhë, pas riparimit të argjinaturës

23 Nëntor, 09:19



Vendi i përfshirë nga shi i dendur, në Shkodër nis dhe dëbora (VIDEO)

22 Nëntor, 17:09



Moti i keq/ Situata në Qarkun Lezhë vijon të jetë problematike, dëme në të treja bashkitë

22 Nëntor, 15:54



Moti i keq/ Ushtria dhe bashkia vijojnë punën për rihapjen e rrugëve në Malësinë e Kurbinit

22 Nëntor, 15:52



Dita e Alfabetit, Begaj në Universitetin e Shkodrës: Mbroni gjuhën nga teknologjia dhe globalizmi

22 Nëntor, 15:11



Përmbytjeve nuk i shpëton as kisha e Barbullojës në Lezhë, besimtarët luten në lokal

22 Nëntor, 11:16



Lezha nën pushtetin e ujit, Report Tv sjell pamjet me dron nga përmbytjet

22 Nëntor, 10:17

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje